

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ORGANIC ALBANIA SHPK

K A P I T U L L I I

EMERTIMI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

N E N I 1 **Emertimi**

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar emertohet ORGANIC ALBANIA e cila krijohet nga ortaku i vetem, si themelues, Z. Gazmir Maksuti, i biri i Vebi dhe Xheko, lindur me 13.04.1966, ne Elbasan e banues ne Elbasan.

N E N I 2 **Forma**

Kjo shoqeri eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

N E N I 3 **Baza juridike**

Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij Statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

N E N I 4 **Selia**

Selia e Shoqerise do te jete ne, Lagja Aqif Pasha, Rruga 28 Nentori, Nr. 29, Elbasan Me vendim te ortakut te vetem selia mund te ndryshohet.



N E N I 5
Territori

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj si ne territorin e Repubikes se Shqiperise ashtu edhe jashte saj.

Shoqeria mund te krijoje dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Repubikes se Shqiperise, ne nje nga menyrat e parashikuara ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, ashtu edhe ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

K A P I T U L L I II
OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

N E N I 6
Objekti

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

“Prodhim, perpunim, export-import i bimeve mjeksore dhe aromatike dhe ekstrakteve te tyre, zarzavateve dhe frutave, lendet dhe produkteve drusore, produkteve dhe nenprodukteve te tjera te natyres, vajrave ushqimore, dhe ne pergjithesi import-export te mallrave te ndryshme.”

N E N I 7
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar, me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te ortakut te vetem.

K A P I T U L L I III
**AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQERISE,
KONFIDENCIALITETI**

N E N I 8
Fusha e autoritetit te ortakut

Fusha e autoritetit te ortakut te vetem dhe perqindja e fitimeve ose e humbjeve do te kene si kriter baze kapitalin e Shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ortaku ne marrjen e vendimeve te edo karakteri, te percaktuara ne kete Statut.



N E N I 9
Libri I shoqerise

Per te saktesar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredheniet e punes, Shoqeria do te cele librin e vet, i cili do te quhet Libri i Shoqerise.

N E N I 10
Konfidencialiteti

Ortaku i vetem si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri, bien dakort qe te mos i ekspozojne asnjje personi te jashtem informacionet qe do t'i disponoje Shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe, cdo lloj materiali, si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

N E N I 11
Dokumentet e destinuara per te tretet

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxirren nga Shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si letrat, saturat, lajmerimet, dhc publikimet e ndryshme etj, duhet te tregojne lexueshem emrin e Shoqerise dhe pas tij fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar "ose inicialet "SHPK", si dhe emrin e administratorit.

K A P I T U L L I IV
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET, DHE
TRANSFORMIMI I TYRE**

N E N I 12
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 (njeqindmije) leke. Ky kapital eshte teresish i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem i cili e zoteron ate si 1 (nje) kuote te vetme. Shoqeria mund ta shtoje ose zvogeloje kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit te ortakut te vetem.

N E N I 13
Kontributet



Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem:

Z. Gazmir Maksuti ka derdhur shumen prej 100 000 (njeqindmije) leke.

N E N I 14
Pjeset e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote plotesisht te shlyer me vlore nominale 100,000 (njeqind mijc) leke.

N E N I 15
Lenja dhe transferimi I pjeseve te kapitalit

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete neqoftese ortaku i vetem vendos per kete. Ai mund te lihet peng sipas legjisacionit ne fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem edhe ne rruge trashegimic. Bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te kapitalit themeltar, me vendim te ortakut te vetem dhe sipas kushteve qe lejohen me ligj.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar (kuotave), duhet te vertetohen me akt notarial.

KAPITULLI V
**STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE
ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

N E N I 16
Ortaku I vetem

Si organ i vetem drejtues i Shoqerise eshte ortaku i vetem, me iniciativen dhe kapitalin e te cilit vepron Shoqeria.

N E N I 17
Kompetencat ortakut te vetem

Per sa kohe qe Shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem, kompetencat e tij do te jene:

- Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per Shoqerine apo per sektore te vecante te veprimtarise.
- Vendos per politiken asariste te Shoqerise dhe percakton fusha konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon administratoret e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te pereaktuara ne Statut.



- Kur e shikon te nevojshme emeron drejtorin ekzekutiv te Shoqerise apo te sektoreve te vecante te saj, duke caktuar ne akt te emerimit dhe kompetencat e tij, kohezgjatjen ne punë etj.
- Shqyrton bilancin vjetor, percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos per marrjen e kredive.
- Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per mbarimin e Shoqerise, likujdimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ne shoqeri te formave te tjera.
- Realizon mardhenie me te rendesishme ekonomike dhe financiare te Shoqerise me persona te tjere fizike apo juridike, vendas apo te huaj.
- Vendos emimet e shitjes, te sherbimeve etj.
- Vendos per pagat e te punesuarve ne Shoqeri.

Pervec kompetencave te lartepermendura, te cilat jane ekskluzive per te, ortaku i vetem, ne rastet kur nuk ka emeruar administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit.

N E N I 18

Administratori dhe kompetencat e tij

Kompetencat e administratorit ose te administratoreve, ne menyre konkrete dhe te detaujar percaktohen ne aktin e emerimit te tyre. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, administratori ka edhe keto kompetencia:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe aktet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjisacionit ne fuqi dhe ia paraqet ortakut te vetem per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.
- Shqyrton ofertat dhe pergaatit kerkesa te cilat ia paraqet ortakut te vetem per miratim.
- Ndjek problemet e Shoqerise ne marredhenjet me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon ortakut te vetem emimet e shitjes dhe te sherbimeve, si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.
- I propozon ortakut te vetem rregulloret per sektore te vecante te Shoqerise.

Emerimi i administratorit do te behet per nje afat kohor te pacaktuar , me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem. Administratori eshte perjeqjes ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te Statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.



KAPITULLI VI

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET

N E N I 19

Librat e Shoqerise

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje, pervec librit te Shoqerise, ne te cilin shenohet emri i plete i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut te vetem, edhe dokumentacionin kontabel dhe librat e tjere.

N E N I 20

Bilanci

Bilanci mbylljet me 31 dhjetor te cdo viti, ku i pari do te jetë 31 dhjetori i vitit 2006. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetem. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit finanziar.

N E N I 21

Dividentet

Ortaku i vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Ai percakton fitimin e vitit finanziar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjanc per rezerven sipas ligjit ose te perektaur nga vete ortaku; fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e meparshme. Keshtu ortaku i vetem perekton dhe dividentin.

KAPITULLI VII

MBARIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

N E N I 22

Mbarimi

Shoqeria mbaron me vendim te ortakut te vetem osc per arsyte te tjera te parashikuara ne ligji.



N E N I 23
Likuidimi

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, ortaku i vetem cakton nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin atij reportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi asfatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar finanziar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Pas pagimit te kreditoreve ortaku i vetem mban pjesen e mbetur te kapitalit.

K A P I T U L L I VIII
MOSMARRVESHJET DHE DISPOZITAT E FUNDIT

N E N I 24
Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do te paraqiten per zgjidhje Gjykates kompetente shqiptare, qe ne rastin konkret eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor e Shkalles se Pare Elbasan.

N E N I 25
Dispozita te fundit

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimi si brenda dhe jashte Shqiperise.

Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohet nga ortaku i vetem.

Ky Statut eshte hartuar ne tre ekzemplare identike, ne gjuhen shqipe, duke patur secili ekzemplar fuqi te njejte ligjore.

20/11/2015

ORTAKU I VETEM

GAZMIR MAKSUTI

